




Agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, po vazhdon aktivitetet e veta lidhur me mbështetjen e biznesit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Një nga këto projekte është edhe Parku i Biznesit në Drenas. Parku i Biznesit në Drenas, tanimë ka një infrastrukturë fizike të kompletuar dhe është e gatshme për shfrytëzim. Faza e parë e aplikimit të bizneseve ka përfunduar dhe bizneset përfituese tanimë kanë filluar ndërtimet e objekteve të tyre, ndërsa me përfituesit e fazës së dytë kemi përmbyllë të gjitha procedurat dhe së shpejti edhe ata do të mund të fillojnë me ndërtime të objekteve të tyre.

Parku i Biznesit në Drenas në kapacitetet e veta ka edhe një numër të ngastrave të lira shumica e ta cilave janë të rezervuara për kompanitë që ofrojnë shërbime si telefoni, internet, Tv kabllovik, ngrohje qendrore, hoteliere, karburante për automjete, gaz industrial, shërbime teknologjike, shërbime të ekselencës etj. dhe për këtë qëllim Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, shpall:

KONKURS

FAZA E TRETE Ë APLIKIMIT

Vendosja e Bizneseve në “Parkun e Biznesit në Drenas”



Ku gjendet Parku i Biznesit në Drenas



Parku i Biznesit në Drenas shtrihet në kilometrin e 22-të përgjatë magjistrales Prishtinë – Pejë, në fshatin Koreticë e Epërme. Në një diametër prej 80 km mbulon çdo cep të kufirit të Kosovës ndërsa në një diametër prej 400 Km ka qasje në korridoret rrugore kryesore pan-evropian nr. 4, 5, 8, 9 dhe 10 si dhe në qytetet kryesore të rajonit: Selanik, Tiranë, Durrës, Shkup, Sofje, Beograd, Zagreb, Sarajevë dhe Podgoricë.

Çka ofron Parku i Biznesit në Drenas

Parku ofron një vend ideal me infrastrukturë të kompletuar dhe shërbime kualitative. Parku i Biznesit ka një sipërfaqe prej 24 ha dhe do të jetë pjesë e një zone të ardhshme industriale me mbi 130 ha. Parku i Biznesit në Drenas ofron lokacione të madhësive të ndryshme për biznese, kryesisht për sektorë të prodhimit dhe shërbimeve. Çdo ngastër ka qasje direkte në rrugët kryesore të Parkut si dhe ka kyçjen individuale në rrjetin kryesor të parkut me kanalizim, ujë të pijes dhe atë industrial, gas, nxemje, telefoni, internet, etj.

Kush mund të aplikojë

Të gjitha bizneset e interesuara, vendore apo të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që i ka përcaktuar Bordi i projektit si dhe kanë programe atraktive në funksion të nxitjes së krijimit të vendeve të reja të punës, zvogëlimit të varfërisë dhe rritjes ekonomike.

Në këtë fazë të drejtë aplikimi kanë edhe bizneset / (kompanitë publike) që ofrojnë shërbime të përbashkëta si: telefoni, internet, Tv kabllorik, ngrohje qendrore, hoteliere, karburante për automjete, gaz industrial, shërbime teknologjike, shërbime të ekselencës etj.,

Bizneset / Kompanitë publike që ofrojnë shërbime të përbashkëta kanë të drejtë aplikimi vetëm në parcelat: Nr. I-01, B, B-6, B-7, B-8 dhe B-10 (dy pjesë).

Tërheqja e aplikacioneve

Dokumenti "Kushtet dhe Kriteret për vendosje të kompanive në PBD" dhe Aplikacionet mund të tërhiqen duke vizituar njërin nga web faqet e poshtë shënuara:

<http://www.mti-ks.org>

<http://www.sme-ks.org>

<http://www.invest-ks.org>

ose në zyrën qendrore të Agjencisë për mbështetje të NVM në, në adresën e poshtëshënuar.

Adresa: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme,

Zyra nr. 16, Rr."Muharrem Fejza" p.n , Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Ku duhet dorëzuar aplikacionet

Formularët e plotësuar për konkurrim dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm mund të dërgohen në mënyrë elektronike në e-mailin zyrtar të Agjencisë për mbështetje të NVM-ve.

sme.nvm@ks-gov.net

me mbishkrim **Aplikacion për Park të Biznesit**

ose

duke sjellë aplikacionet fizikisht në zyrën qendrore të Agjencisë për mbështetje të NVM-ve, te

Znj. Samire Pireva (tel. +38 /0/ 38 200 36 556)

Vërejtje

Në çfarëdo forme që dërgoni materialet kërkoni dëshminë e pranimit të aplikimit tuaj.

Afati i konkurrimit mbetet i hapur deri në plotësimin e parcelave të lira.

Për çdo paqartësi apo informatë shtesë mund të drejtoheni në adresën: sme.nvm@ks-gov.net